

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**'EXTRA GROUP A. F. ' sh.p.k**  
**Dispozita të përgjithshme**

Neni 1  
EMËRTIMI

Sot me datë 01.06.2023 në bazë të Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKB-në" të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimet e këtij statuti.

Ortakët si më poshtë:

**Amarildo STERKAJ** 

**Fatjon BREGU** 

vendosën krijimin e shoqërisë

**'EXTRA GROUP A. F. ' sh.p.k**

Shoqëria e ka selinë në **"Lagjja Perlat Rexhepi, Rruga Gjuhadol, godine 2-kateshe, kati i I-re, zona kadastrale 8593, nr. pasurie 4/33 Shkodër"**

Shoqëria ka të drejtë të çelë filial,degë, e përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë e jashtë saj,në përputhje me legjislacionin shqiptar e ato të vendeve të tjera ku ato do të hapen.

**Fatjon BREGU** është administrator i shoqërisë për afat 5 vjeçar.

Neni 2

Shoqëria **'EXTRA GROUP A. F. ' sh.p.k** e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe dispozitave të parashikuara në dokumentet e krijimit të saj ( statu ti).

Shoqëria **'EXTRA GROUP A. F. ' sh.p.k** është Person Juridik

Neni 3

Shoqëria **'EXTRA GROUP A. F. ' sh.p.k** krijohet për të kryer veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje mbi 10(dhjetë) vjet.S shoqëria mund të zgjatë afatin e veprimtarisë së saj ose mund ta mbyllë akti vitetin e saj para këtij afati,sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut dhe sipas kriterëve që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

Neni 4

Shoqëria për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit me të tretët,përgjigjet vetëm me pasurinë e saj.

Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është futur në kapitalin e shoqërisë.

Pjesëmarrja në këtë shoqëri nuk pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie

Neni 5  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë si objekt:

**Ndërmjetësim në shitje pronash, blerje pronash, qiradhënie, menaxhim projektesh, menaxhim pronash të paluajtshme, organizim eventesh, trajnime profesionale, përfaqesim pronarësh, përfaqesim investitorësh, në lidhje me sektorin e pasurive të paluajtshme. Administrim ambjentesh te përbashkëta. Ndertime, montime, prodhime materiale ndertimi, punime dheu, murature, shembje, ndertime civile, industriale dhe rikonstruksione turistike, bujqesore dhe kompletimi me instalime te nevojshme per to, punime restaurimi, ujesjellësa. Agjenci kembimi valutore, shitje biletash, agjenci turistike si dhe çdo lloj aktiviteti te lejuar me ligj. Ne fushen e ndertimit te impianteve Agro prodhuese dhe perpunuese ne fushen e bujqesise. Punime per ndertimin e serave ne sherbim te bujqesise per prodhimin e produkteve te ndryshme. Punime ne prodhim montim e paneleve solare per prodhimin e energjise. Tregtim artikuj te ndryshëm kozmetikë. Hoteleri dhe sherbime te tjera hotelerie qe lidhen me akomodimin ne hotel (furnizimin e sherbimit te akomodimit ne strukturat akomoduese). Sherbime akomodimi ne hotel (hoteleri). Sherbime nëpërmjet mediave elektronike, digjitale, rrjeteve sociale etj.**

KREU II  
MARRËDHËNIET EKONOMIKO-FINANCIARE

NENI 6  
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 lekë.  
I ndarë ky kapital në 2 pjesë, vlera nominale e secilës është 50000 lekë.  
Ky kapital themeltar zotërohet nga:

<b>Amarildo STERKAJ</b>	<b>50%</b>
<b>Fatjon BREGU</b>	<b>50%</b>

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme si ndërmjet ortakëve ashtu dhe përkundrejt personave të tretë. Transferimi i kapitalit ose pjesëve të tyre në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratim të ortakëve dhe me akt noterial.

Nëqoftëse njëri nga ortakët dëshiron të shesë kuotat e kapitalit të tij, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga ortakët e tjerë, ose aprovimin e tyre unanim për shitjen e pjesës së tij një subjekti tjetër.

Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrëveshje të veçantë ose nga një ekspert kompetent i caktuar nga ortakët.

#### Neni 7

Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit themeltar bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve. Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të veçantë.

#### Neni 8

Fitimet neto të realizuara nga aktiviteti i shoqërisë do të ndahen ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e tyre pjesëmarrëse në kapitalin themeltar.

#### Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdive ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

Bilanci i aktivitetit të shoqërisë përgatitet në fund të vitit e duhet të dorëzohet brenda muajit mars të vitit që vijon.

Bilanci i aktivitetit financiar mund të bëhet nga vetë ortakët ose nga ekspertët e tyre.

Por në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit financiar duhet të aprovohen nga Asambleja e Ortakëve brenda muajve të mbylljes së vitit financiar.

#### Neni 10

Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit.

Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre caktohen nga Asambleja e Ortakëve.

#### Neni 11

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

### KREU III

### TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

#### Neni 12

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

-Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statutin.

-Të kërkojnë dhe tu japin të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra llogarie).

-Të bëjnë propozime dhe t'i paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblesë së Shoqërisë.

-Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

### Neni 13

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe vendimet e Asamblesë(për fondin rezervë).
- Të marrin pjesë në administrimin nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Të respektojnë detyrimet e caktuara nga Asambleja ose nga Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë.

## KREU IV

### ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

### Neni 14

Organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Në Asamble marrin pjesë të gjithë Ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vendosura në kapitalin themeltar të shoqërisë. Asambleja e ortakëve kryen këto funksione:

- Miraton bilancin vjetor të shoqërisë
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themeltar.
- Emëron dhe revokon Administratorin e shoqërisë.
- Emëron dhe revokon ekspertin kontabël të shoqërisë.
- Kryen modifikime në statut sipas ecurive të shoqërisë si dhe kontroll të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e saj në një tip tjetër shoqërie.

### Neni 15

Administratori i shoqërisë është **Fatjon BREGU**, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në, me dhe për llogari të shoqërisë.

Shoqëria merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që mund të vijnë nga veprimet e kryera nga administratori.

Administratori ka afat maksimal 5(pesë)vjet dhe afati është i detyrueshëm të parashikohet në aktet e shoqërisë.

### Neni 16

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutin, si dhe shkelje të kryera nga ai gjatë administrimit të shoqërisë.

## Neni 17

Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë rregullohen me kontrata individuale që do të lidhen me secilin prej tyre.

## KREU V MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

### Neni 18

Veprimtaria e shoqërisë pushon me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratë nëqoftëse Ortakët me vullnetin e tyre të lirë nuk zgjatin këtë afat. Shoqëria mund t'i japë fund aktivitetit të saj dhe para afatit të përcaktuar në aktin e themelimit, me aprovimin e Asamblesë së Ortakëve.

### Neni 19

Kur shoqëria likujdohet plotësisht, Asambleja krijon komisionin e likujdimit në të cilin paraqet bilancin e likujdimit. Pasuria e shoqërisë, pasi shlyen detyrimet e shoqërisë, do të ndahet mes Ortakëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar. Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi i kthehet pronarëve të saj.

## **ORTAKËT E SHOQËRISË**

**'EXTRA GROUP A. F. ' sh.p.k**

**Amarildo STERKAJ**



**Fatjon BREGU**

